



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2245/7 prot.

Datë 16.10.2023

**V E N D I M**

**Nr. 1044/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.10.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-77404-08-14-2023 me objekt “*Blerje mjete pastrimi*”, me fond limit 10,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF, me NUIS L61608005C dhe adresë: Rruga Muhamet Veliu, Pallati ILIAD, Shkalla 1, kati 1, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamëz me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza”, nr.492, Kamëz, Tiranë.

**Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me NIPT K91624505A, me adresë: Fshati Ahmetaq, pranë firmës Ital Kon, Prezë, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021,

datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 15.08.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-77404-08-14-2023 me objekt “Blerje mjete pastrimi”, me fond limit 10,333,333 lekë pa TVSH.

II.2. Në datën 30.08.2023 autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 04.09.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Euro Mega 2010” SHPK	7.552.980 lekë, kualifikuar
2. “Malvina Visoka” PF	7.654.320 lekë, kualifikuar
3. “Besim Kamberi” PF	7.750.505 lekë, kualifikuar
4. “Anbim” SHPK	8.333.333 lekë, kualifikuar
5. “Murati D” SHPK	8.835.714 lekë, kualifikuar
6. “Atlantik 3” SHPK	s’ka paraqitur ofertë
7. “ I&V” SHPK	s’ka paraqitur ofertë

II.4. Në datën 12.09.2023, është publikuar njoftimi i fituesit paraprak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Në datën 14.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2245/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3413 e operatorit ekonomik “Malvina Visoka” PF për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

*“Bazuar ne kriteret e veçanta te kualifikimit, ne DT kerkohej:*

**2.4.2** *Operatori ekonomik në rastet kur nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, përkatësisht me nr. rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota si, adresën e saktë të subjektit që e ka lëshuar këtë dokument, telefoni/e-mail/website, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e subjektit, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

**2.4.3** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë AK-së në datën dhe orën e hapjes së ofertave nga një moster fizike për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, përkatësisht me nr. rendor 1 deri në 12, 14, 21, 22, 29, 41, 42, 43, 44, 45. Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim. Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DT.*

**2.4.4.** *Operatori ekonomik duhet të deklarojë se, do të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dëshmitë për rezultatet e testimit zyrtar për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, përkatësisht me nr. rendor 1 deri 12, të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

*1. Per sa i perket Pika 2.4.2 Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, per artikujt:*

*Nr. 4-Sapun tualeti duarsh 100gr*

*Nr. 7-Solucion per pastrimin e smercit/kriperave*

*Per keto artikuj nuk eshte prodhues dhe duhet te paraqese autorizim prodhuesi/distributori i autorizuar nga nje prodhues.*

*2. Per sa i perket Pika 2.4.3, ditën e dorezimit te mostrave ne prezence konstatuam se OE “Euro Mega 2010” SHPK, nuk ka dorezuar mostrat sipas specifikave teknike te kerkuara ne DST.*

*Konkretisht artikujt:*

*Nr 6- Solucion lares WC, dezinfektues, AK ka kerkuar solucioni te jete i testuar antibakterial per te eliminuar 99.9% te baktereve dhe viruseve. Produkti i dorezuar nuk eshte sipas specifikave.*

*Nr 9-Pastrues lavamanesh, AK ka kerkuar: Produkti te jete i certifikuar per te pastruar efikas lavamanet dhe per te eliminuar se paku 99.9% te bakterieve te zakonshme, OE nuk ka dorzuar moster sipas specifikave teknike.*

*Nr. 43-Qese plehrash te medha 90x60 cm, nuk eshte dorezuar ne permasat e kerkuara nga AK por me permasa te kunderta.*

*Nr. 44-Qese plehrash te medha 70x100 cm, pako me 30 fije, nuk eshte dorezuar sipas kerkeses se AK numri i fijeve.*

*Nr. 45-Qese plehrash te vogla 50x60 cm, pako me 30 fije, nuk eshte dorezuar sipas kerkeses se Ak numri i fijeve.*

*3. Per sa i perket Pika 2.4.4 , OE "Euro Mega 2010" SHPK, nuk ka dorezuar testimet zyrtare sipas parametrave te kerkuara ne DST. Duke marre parasysh qe produktet do perdoren ne ambiente ku frekuentohen femije, per artikujt 1 deri ne 12 vlerat e PH te kerkuara nga AK, perqindja e acidit dhe perqindja e klorit nuk jane ne perputhje me kerkesat e AK.*

*Analizat e dorezuara nga "Euro Mega 2010" SHPK nuk jane ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara ne DT.*

*Specifikimi i Materialeve:*

#### **1. Solucion larës dyshemeje (pllakash)**

*Përbërja kimike:*

- *Tretshmëria në ujë të jetë 100%.*
- *Përdorimi i detergjentëve anionikë të butë dhe të testuar për siguri.*
- *Përdorimi i acidit të butë të pastrimit, në nivele të ulëta, për të minimizuar rrezikun e dëmtimit të pllakave.*
- *Përdorimi i përbërësve të njohur për pastrimin e ambienteve të fëmijëve për të parandaluar reaksione të ndjeshmërisë.*
- *pH: Rreth 4.5 - 6.5 për të siguruar pastrim efikas dhe të shëndetshëm të pllakave pa dëmtuar shtresën e tyre të natyrshme.*

#### **2. Solucion larës xhamash.**

*Përbërja kimike:*

- *Përdorimi i detergjentëve anionikë dhe jojonikë për pastrim efikas të xhamit.*
- *Përçindja e përbërësve të kujdesur që të sigurojë që produkti të jetë i sigurt për xhamin dhe të përmbushë kërkesat e shëndetit dhe sigurisë.*
- *pH: Përçindja e pH-it të balancuar për të larguar ndotjet pa dëmtuar xhamin, zakonisht rreth 6-8.*

#### **3. Sapun i lëngshëm**

*Përbërja kimike:*

- *Përdorimi i bazave të buta të sapunit për pastrim të butë të lëkurës së fëmijëve.*
- *Përdorimi i përbërësve të kujdesur për të minimizuar ndikimin në lëkurën e ndjeshme të fëmijëve.*
- *pH i balancuar për të përputhur me nivelet natyrale të lëkurës së fëmijëve (rreth 5.5 - 7).*

#### 4. **Sapun tualeti duarsh (100 g)**

- Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë.
- Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- Vlera e pH të jetë 7 deri në 10.
- Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr/cm<sup>3</sup>.
- Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95 %. Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se 5 cm.

#### 5. **Acid për pastrim.**

Lloji i acidit:

- Acid Acetic
- Përqindja e acidit acetic: 2-5%
- pH rreth 3.5 - 4.5
- Efikas për pastrimin e baktereve (papastërtive).

#### 6. **Solucion larës WC, dezinfektues.**

Përbërja kimike:

- Përdorimi i përbërësve dezinfektues të njohur, si klor (jo më e madhe se 3.5%), për të eliminuar në mënyrë efikase bakteret, viruset dhe mikroorganizmat e dëmshëm.
- Përdorimi i acidit citrik si agjent pastrues për të larguar ndotjet.
- Produkti duhet të ofrojë një dezinfektim të garantuar dhe të jetë i testuar për të eliminuar së paku 99.9% të baktereve dhe virusëve të zakonshëm.
- pH i balancuar për të siguruar një pastrim dhe dezinfektim të mirë, rreth 2.5 - 3.5.

#### 7. **Solucion për pastrimin e smërçit/kripërave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi.**

Përbërja kimike:

- Përdorimi i solventëve të shpërndarë dhe enzimave për të ndarë yndyrat dhe plehrat nga sipërfaqja e smërçit.
- Produkti siguron një pastrim të thellë dhe efikas të smërçit nga yndyrat, vajrat, grimcat dhe plehrat e tjera të ngurta.
- pH i zgjidhjes është i përshtatshëm për të kryer pastrimin dhe për të ruajtur integritetin e sipërfaqes së smërçit, rreth 7-9.

#### 8. **Hipoklorit Natriumi (Klor i lëngët), ACE ose ekuivalent.**

Përçindja e hipokloritit natrium:

- Përçindja e hipokloritit natrium është 5-6% në produktin e gatshëm për përdorim.
- Produkti është testuar dhe i certifikuar për të eliminuar së paku 99.9% të baktereve dhe viruseve të zakonshëm.
- pH i zgjidhjes është midis 6 dhe 7, për të siguruar një dezinfektim efikas dhe pa dëmtuar sipërfaqen.

#### 9. **Pastrues lavamanësh.**

Përbërja kimike:

- Përdorimi i përbërësve pastrues që largojnë plakën e sapunit, yndyrën dhe plehrat nga sipërfaqja e lavamanëve.

- Produkti është i certifikuar për të pastruar efikas lavamanët dhe për të eliminuar së paku 99.9% të baktereve të zakonshme.
- pH i zgjidhjes është midis 6 dhe 8 për të pastruar efikas, ndërsa ruajtur integritetin e materialeve të lavamanëve.

#### **10. Solucion sgrasatore.**

*Përbërja kimike:*

- Produkti përmban një kombinim të agjentëve sgrasues dhe enzimave të cilët ndihmojnë në largimin e yndyrës, plakës dhe plehrave të tjera të ngurta nga sipërfaqet. Produkti është i testuar dhe i certifikuar për të pastruar me efikasitet yndyrat dhe plakën e vështirë të pastërueshme nga sipërfaqet.
- pH i zgjidhjes është i balancuar për të ndihmuar në pastrimin e yndyrës dhe plakës, ndërsa nuk dëmton sipërfaqen midis 7 dhe 9.

#### **11. Solucion larës parketi.**

*Përbërja:*

- Produkti përmban një formulë të veçantë për pastrimin e parketit, duke përdorur agjente larës dhe të përshtatshëm për llojet e ndryshme të parketit.
- Produkti është i testuar dhe i certifikuar për pastrimin efikas të gëlqerorëve dhe ndotjeve të tjera të zakonshme në parket.
- pH i zgjidhjes është neutral ose lehtë alkalik (midis 7 dhe 9) për të siguruar pastrim të mirë dhe të mos dëmtojë sipërfaqen e parketit.

#### **12. Solucion larës likuid enësh.**

*Përbërja:*

- Produkti përmban agjente pastrimi të cilësisë së lartë dhe enzima për të larguar mbeturinat e ushqimit.
- Produkti është testuar dhe i certifikuar për pastrimin efikas të enëve nga ndotjet ushqimore dhe për të eliminuar yndyrën e vështirë.
- pH i zgjidhjes është i përshtatshëm për pastrim të mirë, rreth 6-8, për të siguruar efikasitet dhe për të ruajtur sasinë e kripërave në enë.

*Kerkojme nga AK te pranoje ankesen e operatorit ekonomik "Malvina Visoka" PF, te rishqyrtoje analizat dhe mostrat e dorezuara nga OE "Euro Mega 2010" SHPK dhe te skualifikoje oferten e OE "Euro Mega 2010" SHPK si oferte ne kundershtrim me specifikimet teknike te kerkuara ne DT.*

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2245/2 date 18.09.2023, me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimes "Malvina Visoka" PF pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik "Euro-Mega 2010" SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në datën 19.09.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2245/3 prot., Formulari i Paraqitjes së Argumenteve nga operatori ekonomik i interesuar “Euro Mega 2010” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

II.8. Në datën 27.09.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2245/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr.7022/1 prot., datë 22.09.2023, me objekt: “*Shkresë përcejellëse*”, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së me datë 22.09.2023 për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Malvina Visoka” PF. Referuar këtij vendimi rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik “Malvina Visoka” PF. Konkretisht nga ana e KSHA-së është arsyetuar si vijon: “[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi u legjitimua me urdhrin nr. 6782, datë 15.09.2023, mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF, verifikoi pretendimet e saj sipas pikave të cituara në ankesë, mori në analizë edhe mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Euro Mega” SHPK dhe konstatoi se asnjë nga pretendimet e paraqitura në ankesë nuk qëndron. Për arsyet e mësipërme, KSHA vendosi mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik “Malvina Visoka” SHPK.”

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 2245/5 prot., datë 03.10.2023 me objekt: “*Kërkesë*”, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të sjellë në KPP, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, mostrat dhe testimet zyrtare për artikujt e kërkuar, të paraqitura nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Në datën 09.10.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2245/6 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr.7474/1 prot., datë 09.10.2023, me objekt: “*Kthim - përgjigje*”, bashkëngjitur mostrat e shoqërisë “Euro Mega 2010” SHPK, si dhe dokumentacioni në përgjigje të shkresës nr. 2245/5, datë 03.10.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” PF se: “*Per sa i perket Pika 2.4.2 Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, per artikujt: Nr 4-Sapun tualeti duarsh 100gr; Nr. 7-Solucion per pastrimin e smercit/kriperave, per keto artikuj operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK nuk eshte prodhues dhe duhet te paraqese autorizim prodhuesi/distributori i autorizuar nga nje prodhues*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.4.2 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, është parashikuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

“2.4.2 Operatori ekonomik në rastet kur nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, përkatësisht me nr. rendor 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota si, adresën e saktë të subjektit që e ka lëshuar këtë dokument, telefoni/e-mail/webside, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e subjektit, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”

III.1.2. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, i ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për plotësimin e këtij kriteri kualifikues për sa i përket artikujve Nr. 4-Sapun tualeti duarsh 100gr dhe Nr. 7-Solucion për pastrimin e smercit/kriperave, konstatohet, se është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

“1- Dokumenti i titulluar “Autorizim distributori”, datë 29.08.2023, lëshuar nga shoqëria “Anhel” SHPK për shoqërinë “Euro Mega 2010” SHPK, ku citohet se:

“Shoqëria “Anhel” SHPK me NIPT ... me objekt të veprimtarisë Imp-Eksp, Tregtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm ushqimore, industriale, bujqësore dhe paketim. Adrese [...], email [...], telefon [...], distributore të autorizuar të kompanisë turke “Tat Chemical Industry and Trading Corporation”. Adresë [...] ; telefon [...] ; fax [...] ; webside: <http://www.tatkimya.com>, prodhues i produkteve të mëposhtme:

1.Sapun tualeti duarsh (75 gram – në 150 gram) të llojit (DEX BEAUTY SOAP)

Autorizon: Shoqërinë “Euro Mega 2010” SHPK me NIPT/NUIS [...], me adresë [...] për të ofertuar me produktet tona të cituara më sipër, në procedurat e prokurimit publik të shpallura nga autoritete kontraktore gjatë vitit 2023, si dhe për të lidhur kontrata furnizimi në rast se shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK shpallet fituese nga këto autoritete kontraktore. Ky autorizim është i vlefshëm për të gjithë periudhën kohore të parashikuar në autorizim, pra për vitin 2023.”

2. Deklaratë e Prodhuesit “Euro Mega 2010” SHPK, me datë 29.08.2023, ku thuhet shprehimisht:

Shoqëria “EURO MEGA 2010” SHPK me NIPT: K91624505A, me objekt të veprimtarisë në fushën e prodhimit të detergjenteve të llojeve të ndryshme, tregtim me shumicë dhe pakicë, import, eksport të detergjenteve dhe mallrave të ndryshme industriale, bujqësore, ushqimor, pijeve freskuese e alkolike, blektoral, lendeve të para për industrinë, duralumini, hidrosanitare, elektro shtepiake, elektronike, elektrike, etj., në përmbushje të kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2 të seksionit 2.4 (Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim), të shtojcës 7 (Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit) të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje mjete pastrimi” me fond limit: 10,333,333 (dhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH, me REF-77404-08-14-2023, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, DEKLARON SE, ËSHTË KOMPANI PRODHUESE E PAJISUR ME “LEJE MJEDISORE TIPIT A” PËR PRODUKTET E MËPOSHTME:



<b>Nr. Produkti sipas shtojcës 6 të DT-së</b>	<b>Emërtimi i produktit</b>
1	Solucion larës dysHEMEJE (pLLAKASH) (1 Litër)
2	Solucion larës XHAMASH ( 750 ml)
3	Sapun likuid per duart 1 Liter
5	Acid për pastrim (1 Litër)
6	Solucion larës WC dezinfektues ( 750 ml)
7	Solucion per pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi
8	Hipoklorit natriumi (Klor i lenget) ACE ose ekuivalent (1 Liter)
9	Pastrues lavamanesh dhe pllakash (1 Liter)
10	Solucion sgrasatore (750ml)
11	Solucion lares parketi (1 Liter)
12	Pastrues lares likuid enesh (1 Liter)

*Sa më sipër nisur nga fakti se, shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK është prodhuese e këtyre produkteve, atëherë deklaron, se në rast se shpallet fituese e kësaj procedure prokurimi atëherë ka të gjitha kapacitetet për të prodhuar produktet e mësipërme sipas të gjitha specifikimeve teknike të përcaktuara nga autoriteti Juaj kontraktor.”*

3. Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit “Euro Mega 2010”, ku në pikën 9, “Objekti i aktivitetit” është përcaktuar objekti i veprimtarisë si vijon: *“Prodhim i detergjenteve të llojeve të ndryshme. Tregtim me shumicë dhe pakice, import, eksport të detergjenteve dhe mallrave të ndryshme industrial, bujqësor, ushqimor, pijeve freskuese e alkoolike, blektoral, lendeve të para për industrinë, duralumini, hidrosanitare, elektro shtëpiake, elektronike, elektrike. Transport për vetë dhe të tretet. Zyre të këmbimeve Valutore. Organizime eventesh të ndryshme. Tregtim materialesh zbulimi dhe ndriçimi. Sherbim dezinfektimi, sherbimin DDD, kancelari , dekor ambientesh , medikamenteve dhe aksesoreve të ndryshme farmaceutik, sherbim pastrimi të ambienteve të brendshme, tregtim të materialeve mbrojtëse për emergjencë si (doreza, maska mbrojtëse, dezinfektant, alkool etilik, alkool izopropilic), tregtim dhe sherbim kimikatesh të ndryshme për dezinfektimin e ujit të pijshëm, tregtim dezinfektuesi xhel duarsh, import, export, tregtim hipoklorit natriumi dhe kalciumi, acid klorhidrik, tregtim dezinfektant për ambiente të jashtme me lende virocidë dhe benzalkoni. Sherbim rrobaqepesie, uniforma pune, mbulesa, qepje, peceta, shtupa etj. Import-Export dhe tregtim tekstile, materiale të buta, kite reagent dhe pajisje laboratorike, tregtim materiale hotelerie.”*

4. Leje mjedisi e tipit A për aktivitetin: “*Prodhimi i kimikateve organike bazë (2)*”, Kodi III.1.C, (lëshuar nga QKB për Subjektin “Euro Mega 2010” SHPK).

5. Leje, Kodi III.1.C, kategoria “*Për ndikimin në mjedis*”, Nënkatgoria “*Leje Mjedisi e tipit A*”. Emërtimi përshkrues i veprimtarisë: “*Procedure e thelluar e vleresimit të ndikimit në mjedis për: "Linje e prodhimit të detergjenteve të lenget Euromega 2010 Sh.P.K. (Shtojca I, pika 6/a)*”.

III.1.3. Në nenin 3 Parime të përgjithshme, të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*” thuhet se: “*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*”

III.1.4. Në nenin 77 “*Kërkesat për kualifikim*”, të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, parashikohet shprehimisht: “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie*”

III.1.5. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 5 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvritimit të mallrave. 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPPsë, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion*”

*apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për sa i përket artikullit Nr. 4 “*Sapun tualeti duarsh 100gr*”, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur në ofertën e tij dokumentin e titulluar “*Autorizim distributori*”, datë 29.08.2023, të lëshuar nga shoqëria “Anhel” SHPK për shoqërinë “Euro Mega 2010” SHPK, sipas të cilit shoqëria “Anhel” SHPK, si distributore e autorizuar e kompanisë turke “Tat Chemical Industry and Trading Corporation”, ka autorizuar shoqërinë “Euro Mega 2010” SHPK për të ofertuar me produktin “Sapun tualeti duarsh (75 gram – në 150 gram) të llojit (DEX BEAUTY SOAP)”, gjatë vitit 2023, si dhe për të lidhur kontrata furnizimi në rast se shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK shpallet fituese nga këto autoritete kontraktore. Ky autorizim është i vlefshëm për të gjithë periudhën kohore të parashikuar në autorizim, pra për vitin 2023. Gjithashtu, në këtë autorizim jepet informacion për adresën e kompanisë prodhuese “Tat Chemical Industry and Trading Corporation”, si dhe telefoni, fax-i dhe website: <http://www.tatkimya.com>, i kompanisë prodhuese, për të kryer verifikimet përkatëse në rast se autoritetit kontraktor do t'i lindin dyshime për saktësinë e dhënave në këtë dokument.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK për artikullin Nr. 4 “*Sapun tualeti duarsh 100gr*”, është

në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.4.2 “*Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim*” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, pasi ka paraqitur autorizim nga distributori i autorizuar i prodhuesit, për artikullin në fjalë dhe ky autorizim përmban të dhëna të plota si, adresën e saktë të subjektit që e ka lëshuar këtë dokument, telefoni/e-mail/website, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e subjektit, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.1.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për sa i përket artikullit Nr. 7- *Solucion per pastrimin e smercit/kriperave*, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur në ofertën e tij, deklaratë me datë 29.08.2023, ku deklaroi, se (në përmbushje të kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2 të seksionit 2.4 (Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim), të shtojcës 7 (Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit) të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje mjete pastrimi” me fond limit: 10,333,333 (dhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH, me REF-77404-08-14-2023, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamze), është kompani prodhuese e pajisur me Leje mjedisore të tipit A për 11 produkte nga 12 produktet për të cilat autoriteti kontraktor kërkon autorizim prodhuesi/distributori të autorizuar, (me përjashtim të artikullit Nr. 4 “Sapun tualeti duarsh 100gr”) si dhe dokumentet “Leja e mjedisit e tipit A për aktivitetin: “*Prodhimi i kimi kateve organike bazë (2)*”, Kodi III.1.C, lëshuar nga QKB-ja” dhe “Leja me emërtimin përshkrues të veprimtarisë: “*Procedure e thelluar e vlerësimit të ndikimit në mjedis për: "Linje e prodhimit të detergjenteve të lënget Euromega 2010 Sh.P.K*, Kodi III.1.C, kategoria “*Për ndikimin në mjedis*”, Nënkatëgoria “*Leje Mjedisore e tipit A*”. Gjithashtu, objekti i aktivitetit të tij sipas ekstraktit të QKB-së është prodhim i detergjenteve të llojeve të ndryshme, tregtim me shumicë dhe pakice, import, eksport të detergjenteve dhe mallrave të ndryshme industriale, bujqesore, ushqimore, pijeve freskuese e alkoolike, blektoral, lëndëve të para për industrinë, duralumini, hidrosanitare, elektro - shtepiake, elektronike, elektrike [...] etj. Kështu, rezultoi e provuar se me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, operatori ekonomik shfaqet në cilësinë e prodhuesit të artikujve të deklaruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” PF se: “*Për sa i përket Pika 2.4.4, OE “Euro Mega 2010” SHPK, nuk ka dorëzuar testimet zyrtare sipas parametrave të kerkuara në DST. Duke marrë parasysh që produktet do perdoren në ambiente ku frekuentohen femije, për artikujt 1 deri në 12 vlerat e PH të kerkuara nga AK, perqindja e acidit dhe perqindja e klorit nuk janë në përputhje me kërkesat e AK*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim”, pika 2.4.4., të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

**2.4.4. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se, do të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dëshmitë për rezultatet e testimit zyrtar për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, përkatësisht me nr. rendor 1 deri 12, të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.**

III.2.2. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të tenderit të publikuar në SPE në datën 15.08.2023, për artikujt me numër rendor 1-12 është parashikuar si vijon:

### **1. Solucion larës dyshemeje (pllakash)**

*Përbërja kimike:*

- *Tretshmëria në ujë të jetë 100%.*
- *Përdorimi i detergjenteve anionikë të butë dhe të testuar për siguri.*
- *Përdorimi i acidit të butë të pastrimit, në nivele të ulëta, për të minimizuar rrezikun e dëmtimit të pllakave.*
- *Përdorimi i përbërësve të njohur për pastrimin e ambienteve të fëmijëve për të parandaluar reaksione të ndjeshmërisë.*
- *pH: Rreth 4.5 - 6.5 për të siguruar pastrim efikas dhe të shëndetshëm të pllakave pa dëmtuar shtresën e tyre të natyrshme.*

*Siguria dhe përdorimi:*

- *Produkti duhet të jetë i sigurt për përdorim në mjediset e fëmijëve dhe të përmbajë informacion të qartë për masat e sigurisë.*
- *Etiketa e produktit duhet të përfshijë udhëzime të detajuara për përdorim.*

*Rekomandime për përdorim:*

- *Udhëzimet duhet të jenë të lehta për tu kuptuar dhe të përputhshme me praktikën e përdorura në kopshte.*
- *Etiketa duhet të përfshijë simbole të rrezikut dhe instruksione të qarta për përdorim dhe ruajtje.*

*Ndikimi në mjedis:*

- *Produkti duhet të jetë i biogradueshëm dhe të përmbushë kërkesat e standardeve mjedisore për përdorim të sigurt në kopshte.*

### **2. Solucion larës xhamash.**

*Përbërja kimike:*

- *Përdorimi i detergjentëve anionikë dhe jojonikë për pastrim efikas të xhamit.*
- *Përqindja e përbërësve të kujdesur që të sigurojë që produkti të jetë i sigurt për xhamin dhe të përmbushë kërkesat e shëndetit dhe sigurisë.*
- *pH: Përqindja e pH-it të balancuar për të larguar ndotjet pa dëmtuar xhamin, zakonisht rreth 6-8.*

*Performanca në largimin e ndotjeve:*

- *Produkti duhet të jetë i efektshëm në largimin e plehrave, vajrave, shkumës, dhe ndotjeve të tjera të zakonshme të xhamit.*

- *Siguria dhe përdorimi:*
- *Produkti duhet të jetë i sigurt për përdorim në ambientet e brendshme dhe të përmbushë kërkesat e standardeve për produkte të pastrimit.*

*Rekomandime për përdorim:*

- *Etiketa e produktit duhet të përmbajë udhëzime të detajuara për përdorim, si dhe masat e sigurisë për përdoruesin.*
- *Produkti duhet të jetë i formuluar për të minimizuar rrezikun e shenjave apo dëmtimit të xhamit.*
- *Etiketa duhet të përfshijë informacion të qartë për produktin, udhëzimet për përdorim dhe masat e sigurisë.*

*Ndikimi në mjedis:*

- *Produkti duhet të përmbushë kërkesat e standardeve mjedisore dhe të jetë i degradueshëm për t'u zvogëluar ndikimi në mjedis.*

### **3. Sapun i lëngshëm**

*Përbërja kimike:*

- *Përdorimi i bazave të buta të sapunit për pastrim të butë të lëkurës së fëmijëve.*
- *Përdorimi i përbërësve të kujdesur për të minimizuar ndikimin në lëkurën e ndjeshme të fëmijëve.*
- *pH i balancuar për të përputhur me nivelet natyrale të lëkurës së fëmijëve (rreth 5.5 - 7).*

*Efikasiteti i pastrimit:*

- *Produkti duhet të ofrojë një pastrim të efektshëm të lëkurës, pa dëmtuar lëkurën.*

*Siguria dhe përdorimi:*

- *Produkti duhet të jetë i sigurt dhe i testuar për përdorim, pa shkaktuar ndjeshmëri apo irritim.*
- *Etiketa e produktit duhet të përmbajë informacion të qartë për masat e sigurisë dhe ndalimin e kontaktit me sytë.*
- *Përdorimi i aromave të buta dhe ngjyrave të qëndrueshme, të njohura për të qenë të sigurta për fëmijët.*

*Rekomandime për përdorim:*

- *Etiketa duhet të përfshijë informacion të qartë për produktin, përmbajtjen, udhëzimet për përdorim dhe masat e sigurisë.*

*Ndikimi në mjedis:*

- *Produkti duhet të përmbushë kërkesat e standardeve mjedisore dhe të jetë i degradueshëm për të zvogëluar ndikimin në mjedis.*

### **4. Sapun tualeti duarsh (100 g)**

- *Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë.*
- *Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.*
- *Vlera e pH të jetë 7 deri në 10.*
- *Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr/cm<sup>3</sup>.*
- *Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se 5 cm.*

## **5. Acid për pastrim.**

Lloji i acidit:

- Acid Acetic
- Përqindja e acidit acetic: 2-5%
- pH rreth 3.5 - 4.5
- Efikas për pastrimin e baktereve (papastërtive).

Siguria dhe kujdesi:

- Produkti duhet të jetë i sigurt për përdorim në mjediset e fëmijëve.
- Etiketa duhet të përmbajë shenjat e rrezikut dhe masa të sigurisë.
- Udhëzime të qarta për përdorim dhe masa të sigurisë duhet të jepen në etiketë.

Etiketa dhe informacioni i produktit:

- Etiketa duhet të përfshijë emrin e produktit, përmbajtjen, udhëzimet për përdorim dhe masat e sigurisë.

Ndikimi në mjedis:

- Produkti duhet të përmbushë kërkesat e standardeve mjedisore dhe të jetë i degradueshëm për të zvogëluar ndikimin në mjedis.

## **6. Solucion larës WC, dezinfektues.**

Përbërja kimike:

- Përdorimi i përbërësve dezinfektues të njohur, si klor (jo më e madhe se 3.5%), për të eliminuar në mënyrë efektive bakteret, viruset dhe mikroorganizmat e dëmshëm.
- Përdorimi i acidit citrik si agjent pastrues për të larguar ndotjet.
- Produkti duhet të ofrojë një dezinfektim të garantuar dhe të jetë i testuar për të eliminuar së paku 99.9% të baktereve dhe virusëve të zakonshëm.
- pH i balancuar për të siguruar një pastrim dhe dezinfektim të mirë, rreth 2.5 - 3.5.

Siguria dhe kujdesi:

- Produkti duhet të jetë i sigurt.
- Etiketa e produktit duhet të përmbajë shenjat e rrezikut dhe të ofrojë udhëzime të detajuara për përdorim, përfshirë masat e sigurisë.
- Përdorimi i aromave të buta dhe ngjyrave të përshtatshme që të krijojë një përvojë të këndshme për përdoruesit.

Rekomandime për përdorim:

- Etiketa e produktit duhet të përmbajë udhëzime të qarta dhe të thjeshta për përdorim dhe masat e sigurisë.
- Etiketa duhet të përfshijë informacion të qartë për produktin, përmbajtjen, udhëzimet për përdorim dhe masat e sigurisë.

Ndikimi në mjedis:

- Produkti duhet të përmbushë kërkesat e standardeve mjedisore dhe të jetë i degradueshëm për të zvogëluar ndikimin në mjedis.

## **7. Solucion për pastrimin e smërçit/kripërave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi.**

Përbërja kimike:

- Përdorimi i solventëve të shpërndarë dhe enzimave për të ndarë yndyrat dhe plehrat nga sipërfaqja e smërçit.

- Produkti siguron një pastrim të thellë dhe efikas të smërçit nga yndyrat, vajrat, grimcat dhe plehrat e tjera të ngurta.
- pH i zgjidhjes është i përshtatshëm për të kryer pastrimin dhe për të ruajtur integritetin e sipërfaqes së smërçit, rreth 7-9.

*Siguria dhe kujdesi:*

- Produkti është i sigurt për përdorim, nuk shkakton ndotje të rrezikshme në mjediset e kopshteve dhe çerdheve.
- Etiketa e produktit përmban udhëzime të qarta për përdorim dhe masa të sigurisë, duke përfshirë mënyrën e mbajtjes së produktit larg fëmijëve.
- Produkti përmban aroma të buta ose nuk ka aromë fare.
- Ngjyra e produktit është transparente ose e butë për të shmangur ndotjen e ngjyrave të smërçit.

*Rekomandime për përdorim:*

- Etiketa e produktit jep udhëzime të detajuara dhe të kuptueshme për përdorim, përfshirë sasinë e rekomanduar dhe procedurat e pastrimit.
- Etiketa përfshin emrin e produktit, përmbajtjen, udhëzimet e përdorimit, masat e sigurisë dhe shenjat e rrezikut.

*Ndikimi në mjedis:*

- Produkti përmbush standardet mjedisore dhe është formuluar për të zvogëluar ndikimin negativ në mjedis.
- Produkti është i testuar dhe i vlerësuar për performancën e tij në pastrimin e smërçit dhe eliminimin e plehrave të ngurta.

#### **8. Hipoklorit Natriumi (Klor i lëngët), ACE ose ekuivalent.**

*Përqindja e hipokloritit natrium:*

- Përqindja e hipokloritit natrium është 5-6% në produktin e gatshëm për përdorim.
- Produkti është testuar dhe i certifikuar për të eliminuar së paku 99.9% të baktereve dhe viruseve të zakonshëm.
- pH i zgjidhjes është midis 6 dhe 7, për të siguruar një dezinfektim efikas dhe pa dëmtuar sipërfaqen.

*Siguria dhe kujdesi:*

- Etiketa e produktit përmban shenjat e rrezikut dhe udhëzime të detajuara për përdorim dhe masat e sigurisë.

*Dilucioni:*

- Rekomandohet të përdoret një raport 1:100 (1 pjesë produkti në 100 pjesë ujë) për dezinfektim të përditshëm.
- Produkti nuk përmban arome dhe ka ngjyrë transparente.

*Rekomandime për përdorim:*

- Etiketa e produktit jep udhëzime të detajuara për përdorim, përfshirë kohën e rekomanduar të kontaktit për dezinfektim.
- Etiketa përfshin emrin e produktit, përmbajtjen, udhëzimet e përdorimit, masat e sigurisë dhe shenjat e rrezikut.

*Ndikimi në mjedis:*



- Produkti përmbush standardet mjedisore dhe është i degradueshëm për të zvogëluar ndikimin në mjedis.

### **9. Pastrues lavamanësh.**

*Përbërja kimike:*

- Përdorimi i përbërësve pastrues që largojnë plakën e sapunit, yndyrën dhe plehurat nga sipërfaqja e lavamanëve.
- Produkti është i certifikuar për të pastruar efikas lavamanët dhe për të eliminuar së paku 99.9% të baktereve të zakonshme.
- pH i zgjidhjes është midis 6 dhe 8 për të pastruar efikas, ndërsa ruajtur integritetin e materialeve të lavamanëve.

*Siguria dhe kujdesi:*

- Etiketa e produktit përmban shenjat e rrezikut dhe udhëzime të qarta për përdorim dhe masat e sigurisë.
- Produkti ka aromë të butë dhe ngjyra të përshtatshme për një përvojë të këndshme të pastrimit.

*Rekomandime për përdorim:*

- Etiketa e produktit jep udhëzime të detajuara për mënyrën e përdorimit, sasinë e nevojshme dhe kohën e kontaktit për pastrim të efikasëm.
- Etiketa përfshin emrin e produktit, përmbajtjen, udhëzimet e përdorimit, masat e sigurisë dhe shenjat e rrezikut.

*Ndikimi në mjedis:*

- Produkti përmbush standardet mjedisore dhe është formuluar për të zvogëluar ndikimin negativ në mjedis.

### **10. Solucion sgrasatore.**

*Përbërja kimike:*

- Produkti përmban një kombinim të agjentëve sgrasues dhe enzimave të cilët ndihmojnë në largimin e yndyrës, plakës dhe plehrave të tjera të ngurta nga sipërfaqet. Produkti është i testuar dhe i certifikuar për të pastruar me efikasitet yndyrat dhe plakën e vështirë të pastërueshme nga sipërfaqet.
- pH i zgjidhjes është i balancuar për të ndihmuar në pastrimin e yndyrës dhe plakës, ndërsa nuk dëmton sipërfaqen midis 7 dhe 9.

*Siguria dhe kujdesi:*

- Produkti është i sigurt për përdorim dhe nuk shkakton ndotje të rrezikshme për mjedisin dhe njerëzit.
- Etiketa e produktit përmban udhëzime të qarta për përdorim, masa të sigurisë, dhe masa për ruajtjen e produktit larg fëmijëve. Produkti përmban aroma të buta dhe ngjyra të përshtatshme për të krijuar një përvojë të këndshme të pastrimit.

*Rekomandime për përdorim:*

- Etiketa e produktit jep udhëzime të detajuara për mënyrën e përdorimit, sasinë e nevojshme dhe kohën e kontaktit për pastrim të efikasëm.
- Etiketa përfshin emrin e produktit, përmbajtjen, udhëzimet e përdorimit, masat e sigurisë dhe shenjat e rrezikut.

*Ndikimi në mjedis:*

- Produkti përmbush standardet mjedisore dhe është formuluar për të zvogëluar ndikimin negativ në mjedis.

### **11. Solucion larës parketi.**

*Përbërja:*

- Produkti përmban një formulë të veçantë për pastrimin e parketit, duke përdorur agjente larës dhe të përshtatshëm për llojet e ndryshme të parketit.
- Produkti është i testuar dhe i certifikuar për pastrimin efikas të gëlqerorëve dhe ndotjeve të tjera të zakonshme në parket.
- pH i zgjidhjes është neutral ose lehtë alkalik (midis 7 dhe 9) për të siguruar pastrim të mirë dhe të mos dëmtojë sipërfaqen e parketit.

*Siguria dhe kujdesi:*

- Etiketa e produktit përmban udhëzime të detajuara për përdorim, masa të sigurisë, dhe masa për ruajtjen e produktit.
- Produkti është i përshtatshëm për të gjitha llojet e parketit dhe nuk shkakton dëme apo ndryshime në material apo ngjyrë.
- Produkti përmban aromë të butë ose nuk ka aromë fare për të përshtatur mjedisin ku janë fëmijë.
- Ngjyra e produktit është transparente ose e butë për të ruajtur pamjen e natyrshme të parketit.

*Rekomandime për përdorim:*

- Etiketa e produktit jep udhëzime të detajuara për mënyrën e përdorimit, sasinë e nevojshme dhe kohën e kontaktit për pastrim të efikasëm.
- Etiketa përfshin emrin e produktit, përmbajtjen, udhëzimet e përdorimit, masat e sigurisë dhe shenjat e rrezikut.

*Ndikimi në mjedis:*

- Produkti përmbush standardet mjedisore dhe është formuluar për të zvogëluar ndikimin negativ në mjedis.

### **12. Solucion larës likuid enësh.**

*Përbërja:*

- Produkti përmban agjente pastrimi të cilësisë së lartë dhe enzima për të larguar mbeturinat e ushqimit.
- Produkti është testuar dhe i certifikuar për pastrimin efikas të enëve nga ndotjet ushqimore dhe për të eliminuar yndyrën e vështirë.
- pH i zgjidhjes është i përshtatshëm për pastrim të mirë, rreth 6-8, për të siguruar efikasitet dhe për të ruajtur sasinë e kripërave në enë.

*Siguria dhe kujdesi:*

- Produkti është i sigurt për përdorim me ushqim dhe nuk shkakton ndotje të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin.
- Etiketa e produktit përmban udhëzime të qarta për përdorim dhe masa të sigurisë.
- Produkti ka aromë të butë ose është i paaromatizuar për të përshtatur mjediset ku janë fëmijë.
- Ngjyra e produktit është transparente ose e butë për të ruajtur pamjen natyrore të enëve.

*Rekomandime për përdorim:*

- Etiketa e produktit ofron udhëzime të detajuara për dozim, si të lahen enët, dhe kohën e nevojshme për pastrim efikas.
- Etiketa përfshin emrin e produktit, përmbajtjen, udhëzimet e përdorimit, masat e sigurisë dhe shenjat e rrezikut.

Ndikimi në mjedis:

- Produkti përmbush standardet mjedisore dhe është formuluar për të minimizuar ndikimin negativ në mjedis.

Ndërsa në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafiku i lëvrimit” të dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, për artikujt 1-12 është parashikuar:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Solucion larës dyshemeje(pllakash) (1 Litër)	copë	6500	Bashkia	30 dite
2	Solucion larës xhamash (750 ml)	copë	800		
3	Sapun likuid per duart 1 Liter	copë	1400		
4	Sapun tualeti duarsh (100 gr)	copë	1000		
5	Acid për pastrim (1 Litër)	copë	2000		
6	Solucion larës WC dezinfektues ( 750 ml)	copë	1100		
7	Solucion per pastrimin e smërcit/kriprave	copë	370		
8	Hipoklorit natriumi (Klor i lenget) ACE ose	litër	4400		
9	Pastrues lavamanesh dhe pllakash (1 Liter)	copë	1600		
10	Solucion sgrasatore (750ml)	copë	1251		
11	Solucion lares parketi (1 Liter)	copë	1100		
12	Pastrues lares likuid enesh (1 Liter)	copë	1000		

III.2.3. Në shtojcën me datë 18.08.2023 të publikuar në SPE me objekt: “Modifikimi i specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje mjete pastrimi” nga ana e autoritetit kontraktor, është bërë modifikimi i specifikimeve teknike si vijon:

**Tek specifikimet teknike për produktin e poshtëshënuara bëhen ndryshimet si vijon:**

**Ishte**

**Artikulli 5. Acid për pastrim.**

Lloji i acidit:

- **Acid Acetic**
- Përqindja e acidit acetic: 2-5%
- pH rreth 3.5 - 4.5
- Efikas për pastrimin e baktereve (papastërtive).

Siguria dhe kujdesi:

- Produkti duhet të jetë i sigurt për përdorim në mjediset e fëmijëve.
- Etiketa duhet të përmbajë shenjat e rrezikut dhe masa të sigurisë.
- Udhëzime të qarta për përdorim dhe masa të sigurisë duhet të jepen në etiketë.

Etiketa dhe informacioni i produktit:

- Etiketa duhet të përfshijë emrin e produktit, përmbajtjen, udhëzimet për përdorim dhe masat e sigurisë.

Ndikimi në mjedis:

- Produkti duhet të përmbushë kërkesat e standardeve mjedisore dhe të jetë i degradueshëm për të zvogëluar ndikimin në mjedis.

### **BËHET:**

#### **Artikulli 5. Acid për pastrim.**

Lloji i acidit:

- **Acid Muratik**
- Përqindja e acidit acetic: 2-5%
- pH rreth 3.5 - 4.5
- Efikas për pastrimin e bakteve (papastërtive).

Siguria dhe kujdesi:

- Produkti duhet të jetë i sigurt për përdorim në mjediset e fëmijëve.
- Etiketa duhet të përmbajë shenjat e rrezikut dhe masa të sigurisë.
- Udhëzime të qarta për përdorim dhe masa të sigurisë duhet të jepen në etiketë.

Etiketa dhe informacioni i produktit:

- Etiketa duhet të përfshijë emrin e produktit, përmbajtjen, udhëzimet për përdorim dhe masat e sigurisë.

Ndikimi në mjedis:

- Produkti duhet të përmbushë kërkesat e standardeve mjedisore dhe të jetë i degradueshëm për të zvogëluar ndikimin në mjedis.

**Ishte:**

#### **Artikulli 8. Hipoklorit Natriumi (Klor i lëngët), ACE ose ekuivalent.**

Përqindja e hipokloritit natrium:

- Përqindja e hipokloritit natrium është 5-6% në produktin e gatshëm për përdorim.
- Produkti është testuar dhe i certifikuar për të eliminuar së paku 99.9% të bakteve dhe viruseve të zakonshëm.
- pH i zgjidhjes është midis 6 dhe 7, për të siguruar një dezinfektim efikas dhe pa dëmtuar sipërfaqen.

Siguria dhe kujdesi:

- Etiketa e produktit përmban shenjat e rrezikut dhe udhëzime të detajuara për përdorim dhe masat e sigurisë.

Dilucioni:

- Rekomandohet të përdoret një raport 1:100 (1 pjesë produkti në 100 pjesë ujë) për dezinfektim të përditshëm.
- Produkti nuk përmban arome dhe ka ngjyrë transparente.

Rekomandime për përdorim:

- Etiketa e produktit jep udhëzime të detajuara për përdorim, përfshirë kohën e rekomanduar të kontaktit për dezinfektim.
- Etiketa përfshin emrin e produktit, përmbajtjen, udhëzimet e përdorimit, masat e sigurisë dhe shenjat e rrezikut.

Ndikimi në mjedis:

Produkti përmbush standardet mjedisore dhe është i degradueshëm për të zvogëluar ndikimin në mjedis.

### **BËHET:**

#### ***Artikulli 8.Hipoklorit Natriumi (Klor i lëngët), ACE ose ekuivalent.***

*Përçindja e hipokloritit natrium:*

- *Përçindja e hipokloritit natrium është 5-6% në produktin e gatshëm për përdorim.*
- *Produkti është testuar dhe i certifikuar për të eliminuar së paku 99.9% të bakteve dhe viruseve të zakonshëm.*

*Siguria dhe kujdesi:*

- *Etiketa e produktit përmban shenjat e rrezikut dhe udhëzime të detajuara për përdorim dhe masat e sigurisë.*

*Dilucioni:*

- *Rekomandohet të përdoret një raport 1:100 (1 pjesë produkti në 100 pjesë ujë) për dezinfektim të përditshëm.*
- *Produkti nuk përmban arome dhe ka ngjyrë transparente.*

*Rekomandime për përdorim:*

- *Etiketa e produktit jep udhëzime të detajuara për përdorim, përfshirë kohën e rekomanduar të kontaktit për dezinfektim.*
- *Etiketa përfshin emrin e produktit, përmbajtjen, udhëzimet e përdorimit, masat e sigurisë dhe shenjat e rrezikut.*

*Ndikimi në mjedis:*

*Produkti përmbush standardet mjedisore dhe është i degradueshëm për të zvogëluar ndikimin në mjedis.*

### **Tek preventivi**

*Zëri me nr. 14 “Cbllokues lavamanesh xhel hidraulik me bidon” ndryshon si vijon:*

#### **Ishte:**

*14. Cbllokues lavamanesh xhel hidraulik me bidon **(1.5 Liter)***

#### **BËHET:**

*14 Cbllokues lavamanesh xhel hidraulik me bidon **(1 Liter)***

#### **Të gjithë elementët e tjerë mbeten të pandryshuar**

III.2.4. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, ( S.P.E.) Komisioni konstatoi, se në funksion të plotësisimit të kriterit të parashikuar në shtojcën 7, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, “*Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim*”, pika 2.4.4., të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, si më sipër cituar, operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur në SPE dokumentin e emërtuar: “*Deklarata për kriterin e pikës 4*”, ku thuhet shprehimisht:

*“Shoqëria “EURO MEGA 2010” SHPK me NIPT K91624505A, me objekt të veprimtarisë në fushën e prodhimit të detergjenteve të llojeve të ndryshme, tregtim me shumicë dhe pakicë, import, eksport të detergjenteve dhe mallrave të ndryshme industriale etj., në përmbushje të kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.4 të seksionit 2.4 Kapaciteti teknik, të shtojcës 7 (Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit) të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje mjete pastrimi” me fond limit: 10,333,333 (dhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH, me REF-77404-08-14-2023, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, deklaron se, do të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dëshmitë për rezultatet*

e testimiit zyrtar për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, përkatësisht me nr. rendor 1 deri 12, të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Gjithashtu, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, drejtuar autoritetit kontraktor nëpërmjet shkresës me nr. 2245/5 prot., datë 03.10.2023, nga ana e këtij të fundit janë paraqitur në KPP dëshmitë për rezultatet e testeve të kryera nga shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK për artikujt “Sapun i lëngshëm”, “Sapun “Berry beauty soap red rose”, “Larës pllakash”, “Solucion për xhama”, “Acid klorhidrik”, “Gel WC”, “Solucion për pastrim smerci 750 ml”, “Hipoklorit natriumi (NaOCl)”, “Solucion WC 11”, “Solucion kundra yndyrës”, “Solucion për parketin”, “Solucion larës enësh lëng”, me treguesit e kontestuar nga ankimesi si vijon:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Vlera PH		Perqindja e acidit		Perqindja e klorit	
		Sipas DST	Ofruar	Sipas DST	Ofruar	Sipas DST	Ofruar
1	Sapun i lëngshëm	5.5-7	5.8	-	-	-	-
2	Sapun “Berry beauty soap red rose	7-10	-	-	-	-	-
3	Larës pllakash	4.5-6.5	5.9	-	-	-	-
4	Solucion për xhama	6-8	7	-	-	-	-
5	Acid klorhidrik (DST Muratik)	3.5-4.5	-	2-5 %	-	-	-
6	Gel WC	-	6.7	-	-	-	-
7	Solucion për pastrim smerci 750 ml	7-9	1.02	-	-	-	-
8	Hipoklorit natriumi (NaOCl)	-	-	-	-	5-6%	-
9	Solucion WC 11	2.5-3.5	4.9	-	-	-	-
10	Solucion kundra yndyrës	7-9	10	-	-	-	-
11	Solucion për parketin	7-9	8	-	-	-	-
12	Solucion larës enësh lëng	6-8	8.3	-	-	-	-
13	Pastrues lavamanesh	6-8	S’ka	-	-	-	-

III.2.5. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuar plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor"

Neni 77 "Kërkesat për kualifikim", të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

*“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.2.6. Neni 40 pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

*3.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.2.7. Neni 40 pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.*

*c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.2.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për



të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.9. Në rastin konkret, bazuar në specifikimet teknike të mallrave objekt-prokurimi, Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor është tepër rëndësishme që të prokurojë mallra që plotësojnë specifikimet teknike, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar të gjitha specifikimet teknike për mallrat/produktet objekt-prokurimi, si dhe duke përcaktuar në kriterin e veçantë të kualifikimit (citojmë) Operatori ekonomik duhet të deklarojë se, do të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dëshmitë për rezultatet e testimit zyrtar për artikujt e kërkuar në shtojcen 6, përkatësisht me nr. rendor 1 deri 12, të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

Nisur nga pretendimet e ankimuesit, si dhe nga shqyrtimi i dokumenteve të dorëzuara nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, konstatohet si vijon:

1. Për artikullin nr.4 “Sapun tualeti duarsh” nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që vlera e PH të jetë 7 deri në 10, ndërkohë që rezulton se shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur certifikate analizë për “Sapun “Berry beauty soap red rose”, por në të nuk jepen të dhëna për treguesin PH.
2. Për artikullin nr.5 “Acid Muratik” nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar vlera e PH të jetë 3.5-4.5, dhe përqindja e acidit 2-5% ndërkohë që rezulton se shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur raport - analizë nr. 1004 për “Acid Klohidrik” që nuk përmban të dhëna për treguesin e PH dhe të acidit.
3. Për artikullin nr.6 “Solucion larës WC” nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar vlera e PH të jetë 7-9, ndërkohë që rezulton se shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur 2 raport - analizë: “Gel WC” dhe “Solucion WC 11”, por treguesi PH i kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk plotësohet nga asnjë prej raporteve të paraqitura pasi vlerat e PH të sipas këtyre raport - analizave janë më të mëdha se nevojat e parashikuara në DT dhe përkatësisht 6.7 dhe 4.9 nga 2.5-3.5 të kërkuar.
4. Për artikullin 7 “Solucion për pastrimin e smërcit” nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar vlera e PH të jetë 7-9, ndërkohë që rezulton, se shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur raport - analizë për “Solucion për pastrim smërçi” me tregues PH 1.02 nga 7-9 të kërkuar në DT.
5. Për artikullin nr.8 “Hipoklorit Natriumi” nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që përqindja e klorit të jetë 5-6%, ndërkohë që rezulton, se shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur raport - analizë për artikullin në fjalë, por që nuk përmban të dhëna për përqindjen e klorit.
6. Për artikullin nr.10 “Solucion sgrasatore” nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar vlera e PH të jetë 7-9, ndërkohë që rezulton, se shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur raport - analizë për artikullin “Solucion kundër yndyrës” me tregues të PH 10, pra më e madhe se kërkesa e autoritetit kontraktor.

7. Për artikullin nr.12 “Solucion larës likuid enësh” nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar vlera e PH të jetë 6-8, ndërkohë që shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur raport - analizë për “Solucion larës enësh lëng” me tregues të PH 8.3, pra më e madhe se kërkesa e autoritetit kontraktor.
8. Për artikullin 9 “Pastrues lavamanësh” nuk rezulton të jetë paraqitur raport - analizë nga ana e shoqërisë “Euro Mega 2010” SHPK.

III.2.10. Pra sa më sipër, duke qenë se autoriteti kontraktor, në kriteret e kualifikimit ka kërkuar shprehimisht përmbushjen e kërkesës për dëshmitë me rezultatet e testimave zyrtare për artikujt e kërkuar në shtojcën 6, përkatësisht me nr. rendor 1 deri 12, [...] që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, i cili pretendon të fitojë kontratën, nuk e ka përmbushur këtë kriter, pasi për artikujt nr.4 “Sapun tualeti duarsh”, nr.5 “Acid Muratik”, nr.6 “Solucion larës WC”, nr. 7 “Solucion për pastrimin e smërcit”, nr.10 “Solucion sgrasatore”, nr.12 “Solucion larës likuid enësh” nuk plotëson vlerat e PH, në kundërshtim me parametrat e parashikuara në dokumentet e tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit. Gjithashtu, për artikullin nr.5 “Acid Muratik” nuk plotësohet kërkesa për përqindjen e acidit si dhe për artikullin nr.8 “Hipoklorit Natriumi”, raport - analiza e paraqitur nuk jep asnjë informacion për përqindjen e klorit, duke mos plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor që përqindja e klorit në këtë artikull të jetë 5-6%. Për më tepër që për artikullin nr.9 “Pastrues lavamani” nga ky subjekt nuk rezulton të jetë paraqitur raport - analize, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit, si më sipër cituar. Sqarojmë, se bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” PF qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në procedurën e prokurimit objekt -ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet sipas pikës III.2 të arsyetimit qëndrojnë, dhe gjendja faktike juridike e subjektit “Euro Mega 2010” SHPK pas arsyetimit të KPP do të ndryshojë, duke u skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të operatorit ekonomik objekt -ankimi, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave

*Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-77404-08-14-2023 me objekt “*Blerje mjete pastrimi*”, me fond limit 10,333,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, duke e skualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

